


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË



PERIUDHA	1M	3M	VITI	1V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	0.41%	4.85%	4.85%	10.41%	33.78%	35.04%
BENÇMARKU	0.08%	0.55%	0.55%	-0.39%	14.31%	32.02%

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM1 2015

ÇMIMI I AKSIONIT:

JANAR	▲ +1.71%
SHKURT	▲ +2.66%
MARS	▲ +0.42%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▲ +4.85%


KTHIMI BRUTO:

JANAR	€19.23 mln
SHKURT	€30.16 mln
MARS	€5.38 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	€54.78 mln

FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT €1.3504	MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,168,245,351
PENSIONE TË SHPAGUARA NË TREMUJOR €5.52 mln	PENSIONE TË SHPAGUARA NË VITIN 2015 €5.52 mln
NUMRI I TË PENSIONUARVE NË TREMUJOR 1,459	NUMRI I TË PENSIONUARVE PËR VITIN 1,459
LLOGARI TË KONTRIBUESVE 482,153	KONTRIBUES AKTIVË 243,250
KONTRIBUES TË RINJ NË TM1 5,628	KONTRIBUTET E REJA NË TM1 €32.69 mln
SHËRBIMET E OFRUARA NË TM1 18,680	PËRDORUES TË eTRUSTIT 40,810

PLASMANI I MJETEVE TË INVESTUARA MË 31.03.2015



€55 MLN KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM1

FKPK-ja e mbylli tremujorin e parë (TM1) të 2015-s me një kthim bruto nga investimet prej rreth €55 mln. Ky kthim është dukshëm vlera më e lartë e arritur ndonjëherë nga FKPK-ja në një tremujor të vetëm. Performanca pozitive e investimeve ndikoi në rritjen e çmimit të aksionit për 4.85%, duke arritur në fund të tremujorit në €1.3504 (tremujori paraprak: €1.2879).

Mjetet nën menaxhim në fund të TM1 tejkaluan shifrën €1,168 mln (tremujori paraprak: €1,088 mln) një ngritje kjo prej rreth €80.48 mln, që është gjithashtu rritja më e lartë e mjeteve nën menaxhim në një tremujor.

Rritja e mjeteve nën menaxhim u ndikua më shumë nga kthimi nga investimet (€54.77 mln) dhe më pak nga kontributet e reja (€32.69 mln). Në anën tjetër FKPK-ja shpagoi pensione prej €5.52 mln dhe ndali për tarifën menaxhuese €1.46 mln, duke i reduktuar kështu mjetet nën menaxhim me rreth €6.98 mln.

FAKTORËT ME NDIKIM

Tregjet financiare globale gjatë TM1 lëvizën në kahun pozitiv, ku tregu i aksioneve vazhdoi rritjen, ndërkohë që tregu i bonove pësoi rënie për shkak të pritshmërisë se lehtësirat monetare në SHBA e BE do të tkurrëshin. Ishte inkurajues fakti se këtë tremujor tregu ndërkombëtar i aksioneve në vendet e zhvilluara tejkaloi performancën e këtij tregu në SHBA dhe vendet në zhvillim, duke dhënë shenja të rritjes më të ekuilibruar të ekonomisë globale. Gjithsesi vazhdimi i programit stimulues në SHBA, BE dhe Japoni ishte mbështetja kryesore për besimin e investitorëve.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Ky ishte një tremujor me performancë të shkëlqyeshme të fondeve investuese të angazhuara nga FKPK-ja në gjysmën e dytë të 2014-s, dhe të cilat ishin të dominuara nga investimet në tregun e aksioneve. Fondi i aksioneve i Nordea 1-GSEF impresionoi me performancën tremujore prej 15.17%, e ndjekur nga fondet e përqendruara po në aksione të Pictet (+13.26%) e KBI (+11.67%), dhe fondi i dominuar prej aksioneve por me ¼ në bono i AXA WFOI (+9.24%). Fondet e aksioneve të Tobam (+5.08%) dhe Vanguard (+4.52%) ishin me performancën të kënaqshme, ndërsa fondet që përmbanin bono në portofolet investuese: Nordea 1-SRF (+4.25%), AXA GILB (+3.43%) dhe Alceda (+1.61%) u ndikuan nga kombinimet më pak të favorshme me bono shtetërore që ulën normat e kthimit. I vetmi fond me performancë negative, edhe pse në masë simbolike (-0.05%), ishte ai i Schrodgers me pozicionim të plotë në tregun e bonove. Si zakonisht, investimet në fletobligacionet e Kosovës janë me normë të interesit që përcaktohet në ankandin primar, dhe ky tremujor kishte një normë rekorde të interesit (+2.29), për shkak se FKPK-ja po investon më shumë mjete në fletobligacione të Thesarit të Kosovës me afat maturimi mbi 12 muaj, që kanë edhe norma më të larta të interesit.

KTHIMI NGA INVESTIMET PËR TM1

4.85%

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT	PLASMANET	PERFORMANCA
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€358,634,502	4.52%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€175,113,236	5.39%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€114,458,188	-0.05%
Nordea	1-Stable Return Fund	€105,100,228	4.25%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€74,603,786	2.29%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€74,399,760	3.43%
KBI	Divident Plus	€61,332,254	11.67%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€57,933,487	15.17%
TOBAM	Anti-benchmark WEFÉ hedged share class	€38,523,289	5.08%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€34,201,210	13.26%
Alceda	Aquila Risk Parity 7 Fund	€29,267,347	1.61%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€28,715,636	9.24%
GJITHSEJ		€1,152,282,923	4.58%

KUVENDI I MIRATOI TARIFAT E FKPK-SË PËR 2015-N

Kuvendi i Kosovës i ka miratuar në mars tarifat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) për vitin 2015. Kuvendi e pranoi kërkesën e Bordit Drejtues të FKPK-së që për aktivitetet investuese të ngarkojë tarifë prej 0.40% ndaj mjeteve nën menaxhim, duke e mbajtur kështu të njëjtë me vitin paraprak (2014: 0.40%).

Njëkohësisht Kuvendi vendosi që tarifa për aktivitetet operacionale të jetë 0.085%, e ulur nga 0.13% që ishte për vitin 2014. Në këtë nivel tarifa operacionale e FKPK-së do të jetë ndër më të ulëtat në gjitha vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (e njohur si OECD) dhe më gjerë.

U HAPËN KONKURSET PËR EMËRIMIN/RIEMËRIMIN E GJASHTË ANËTARËVE TË BORDIT

Gjatë marsit është mbyllur konkursi për përzgjedhjen e një anëtari profesional të Bordit, mandati i të cilit kishte skaduar në janar 2015, ndërsa më pas është hapur edhe konkursi për pesë pozita të tjera: një përfaqësues i punonjësve dhe katër pozita profesionale, mandati i të cilëve skadon në korrik të 2015-s. Në rast se për këto pesë pozita dështojnë të plotësohen deri në tetor të këtij viti, Bordi Drejtues do të ngelet pa mundësinë për të marrë çfarëdo vendimi.

Pas përmbylljes së konkurseve dokumentacionet përcjellëse të secilit kandidat i janë dërguar Bankës Qendrore të Kosovës, e cila edhe e udhëheqë Komisionin Përzgjedhës në përbërje: Guvernatori i BQK-së, Ministri i Financave dhe Auditori Gjeneral. Ky Komision më pas ia dërgon emrat e propozuar për miratim nga Kuvendi i Kosovës.

Konkurset janë shpallur në dy gazeta ditore në vend, në uebfaqen e FKPK-së dhe në revistën ndërkombëtare "The Economist".

REKORD I PENSIONEVE TË SHPAGUARA NË TM1

Vlera e pensioneve të shpaguara në TM1 2015 ka njohur një rritje të fortë duke kapur shifrën rekorde të një tremujori prej €5.5 mln. Kjo përbën një rritje në vlerën e tërhequr prej 45% krahasuar me TM1 2014, ndërkohë që numri i kontribuuesve për të njëjtën periudhë është shtuar për 35% (nga 1,085 në 1,459). Rritja e çmimit të aksionit nga investimi i mjeteve pensionale në tregjet globale (me 4.85%) ishte një kontribuues i rëndësishëm i rritjes së mjeteve që u janë kaluar përfituesve në llogari.

Persona që arrihen moshën e pensionimit ishin 1,162 (ose 79.6% e mjeteve të shpaguara), 230 (ose 15.8% trashëgimtarë) ishin të kontribuuesve që ndërruan jetë para pensionimit dhe 67 (ose 4.6% përfitues) ishin raste të invaliditetit.

RRETH 19 MIJË SHËRBIME TË OFRUARA NË TM1

Kontribuuesit morën për 21% më shumë shërbime gjatë TM1 2015 sesa tremujorin paraprak (18,680 kundrejt 15,421 shërbime tre muaj më parë). Tri shërbimet më të kërkuara nga kontribuuesit ishin: shtypja e pasqyrave për punëmarrësit (50%), aktivizimi i shërbimit eTrusti (20%) dhe shtypja e pasqyrave për punëdhënësit (8%).

Numri i shërbimeve të vetëkryera nga kontribuuesit arriti në 2,620 ose 37% më shumë se tremujorin paraprak (TM4 2014: 1,909). Gjithashtu kontribuuesit morën 11,385 shërbime edhe zyrat rajonale të ATK-së për kursimet pensionale, dhe 87% prej këtyre shërbimeve ishte kërkesa për shtypjen e pasqyrave të llogarive të kursimit pensional.

Në total kontribuuesit i morën ose i kryen 32,808 shërbime rreth kursimeve pensionale, numër ky që është sa 13.5% e kontribuuesve aktivë në fund të kësaj periudhe (243,250).

AFËR 41 MIJË PËRDORUES AKTIVIZUAN eTRUSTI-N

Numri i përdoruesve të shërbimit elektronik eTrusti vazhdoi rritjen edhe më 2015 me një ritëm më të shpejtë se tremujorin paraprak. Numri i përdoruesve në fund të TM1 arriti në 40,810 (TM4 2014: 37,222 përdorues), një rritje kjo prej 10% për tre muaj. Zakonisht gjatë tremujorit të parë të vitit kontribuuesit janë më të sensibilizuar për kursimet pensionale pasi u dërgohet pasqyra vjetore e gjendjes së llogarisë.

Pritjet e FKPK-së janë që deri në fund të 2015-s numri i përdoruesve të eTrusti-t të tejkalojë shifrën 50 mijë, për të përbërë kështu rreth 1/6 e kontribuuesve aktivë ose rreth 10% të totalit të llogarimbajtësve. Për kujtim, shërbimi eTrusti ofrohet pa pagesë dhe procedura e aplikimit bëhet përmes e-mailit, duke dërguar dokumentin identifikues të kontribuuesit (letërnjoftimin ose pasaportën).

ATK NDRYSHON PLATFORMËN E RAPORTIMIT PËR PUNËDHËNËSIT

Gjatë marsit Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-ja) e ka ndryshuar platformën elektronike të raportimit për punëdhënësit (EDI). Me këtë përmirësim të EDI-t punëdhënësve u është vendosur një filter që nuk lejon futjen e numrave personalë ose emrave të pasaktë të kontributdhënësve.

Deri më tani, edhe pse nuk ka qenë shumë tejet e lartë, vlera e mjeteve që nuk mund të alokohej në llogaritë e kontribuuesve për shkak se punëdhënësit raportonin numra personalë ose emra të gabuar të punonjësve ka qenë shqetësim i vazhdueshëm për Menaxhmentin e FKPK-së, i cili edhe ka komunikuar me ATK-në eliminimin e këtij problemi.

Implementimi i plotë i këtij ndryshimi pritet të finalizohet gjatë muajit prill.

FKPK-JA IA DËRGOI POSTËS SË KOSOVËS PËR SHPËRNDARJE 436,973 PASQYRA

FKPK-ja në mes të janarit i ka dërguar për shtypje 436,973 pasqyrat vjetore të kontribuuesve, dhe të njëjtat në fillim të shkurtit i janë dërguar Postës së Kosovës për shpërndarje. FKPK-ja nuk i ka dërguar për shtypje 24,548 pasqyra të kontribuuesve të pensionuar dhe 15,038 pasqyra për të cilat nuk kishte adresë. Nga fillimi i shkurtit Posta e Kosovës ka filluar shpërndarjen e pasqyrave dhe procesi i shpërndarjes vazhdon edhe gjatë prillit.

Deri në javën e tretë të prillit Posta e Kosovës e ka njoftuar FKPK-në se mbi 23 mijë pasqyra nuk ishte e mundur të shpërndahen për shkak se kontribuuesit e kanë ndryshuar vendbanimin ose adresa e tyre ka qenë e pasaktë.

FKPK-ja vazhdimisht u ka kërkuar kontribuuesve që të konfirmojnë adresat e tyre. Gjatë 2014-s janë korrigjuar gjithsej 10,668 adresa, nga të cilat: përmes zyrës së FKPK-së (5,264), zyrave të ATK-së (1,663) dhe eTrusti-t (3,741).

PËRGATITJA E RAPORTIT VJETOR DHE PASQYRAVE FINANCIARE

Në tremujorin e parë FKPK-ja ka qenë e fokusuar në përgatitjen e raportit narrativ si dhe të pasqyrave financiare për vitin 2014. Raporti Vjetor 2014 do të jetë gati jo më vonë se më 31 maj 2015, ku do të prezantohen të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të vitit, si nga fusha e investimeve dhe ajo e operacioneve.

Ndërkohë pasqyrat financiare (për investimet dhe operacionet) janë përfunduar dhe të njëjtat janë publikuar në uebfaqen e FKPK-së. Me shumë rëndësi fakti se edhe këtë vit FKPK-ja mori vlerësim pozitiv nga auditori i jashtëm profesional, i cili gjykoi se: "pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës – për mjetet pensionale/operacionet – deri më 31 dhjetor 2014, performancën financiare dhe rrjedhjet e parasë për vitin e përfunduar më atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar".

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Maj 2015

REDAKTOR

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

DIZAJNI:

Labinot Pasjaqa

KONTAKT

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10,
10000 Prishtinë

038-244-341

info@trusti.org
www.trusti.org